

VENDIM
Nr.259, datë 28.4.2005

**PËR LICENCIMIN E PERSONAVE FIZIKË E JURIDIKË, SI VLERËSUES TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni i posaçëm, pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, të pajisë me licencë personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e vlerësimit të pasurive të paluajtshme.

2. Në këtë komision të marrin pjesë, si anëtarë:

- 4 përfaqësues nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit;
- 1 përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë;
- 1 përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;
- 1 përfaqësues nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- 1 përfaqësues nga Shoqata e Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme;
- 1 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.

3. Çdo person fizik e juridik, publik e privat, i licencuar, pajiset me licencë profesionale, sipas kushteve dhe kriterëve që do të përcaktohen në rregulloren për dhënien e licencave për vlerësimin e pasurive të paluajtshme.

Licenca për personat juridikë jepet për një afat 5-vjeçar, me të drejtë rinovimi, ndërsa për personat fizikë licenca është e përhershme.

Rinovimi dhe heqja e licencave bëhen në përputhje me rregulloren e përmendur në paragrafin e parë të kësaj pike.

4. Llojet e licencave profesionale janë:

- Licenca personale e personit fizik;

- Licenca për një shoqëri, si person juridik, e cila jepet në bazë të licencës personale të personit fizik.

5. Licenca profesionale personale për personin fizik apo për një shoqëri, person juridik, jepet për këto sende të paluajtshme:

- Për ndërtesat;
- Për tokë truall, tokë bujqësore, tokë pyjore, kullotë, livadh dhe tokë të pafrutshme.

6. Çdo person fizik e juridik, që do të ushtrojë veprimtari për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, regjistrohet në një regjistër të veçantë, i cili mbahet në sektorin e licencave, në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

Personat fizikë e juridikë, që nuk janë të pajisur me licencë nuk kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtari për vlerësimin e këtyre pasurive.

7. Rregullorja për kriteret, procedurat e dhënies së licencave profesionale për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, organizimi, funksionimi dhe shpërblymimi i anëtarëve të komisionit të posaçëm miratohet nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

8. Pajisja e personave fizikë e juridikë, me licencë profesionale të bëhet brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentacionit përkatës. Nëse kërkesa refuzohet, personit fizik e juridik, i lind e drejta e ankimit pranë ministrit përgjegjës, që mbulon këtë fushë, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, ndërsa ndaj vendimit të ministrit, personit fizik e juridik, i lind e drejta, që brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të ministrit, të bëjë ankim në gjykatë.

9. Vendimi nr.394, datë 27.5.1996 i Këshillit të Ministrave “Për dhënien e licencave profesionale për vlerësimin e pasurive të paluajtshme”, shfuqizohet.

10. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij

vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano